

# UDHËZUES PRAKTIK PËR RRJETIN E MËSUESVE KOORDINATORË PËR NDJEKJEN E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM





---

# UDHËZUES PRAKTIK PËR RRJETIN E MËSUESVE KOORDINATORË PËR NDJEKJEN E PLANIT TË VEPRIMIT KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

*Tiranë  
Maj, 2021*

---

Ky udhëzues u hartua në kuadër të projektit: “Promovimi edukimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm” i cili po zbatohet nga Shoqata Internacionale për Solidaritetin (SHIS) në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), falë mbështetjes financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë.



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve  
me Publikun të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë

® **Të gjitha të drejtat të rezervuara.**

Ky dokument u prodhua me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit. Udhëzuesi është realizuar si pjesë e projektit “Promovimi i edukimit për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë.

**Autorët:**

Anila Ferizaj  
Eda Buci Lleshaj  
Esion Zgjana

**Me mbështetjen e koordinatores së projektit: Jora Katro, SHIS**

**Për më shumë informacion kontaktoni:**

© Shoqatën Internacionale për Solidaritetin (SHIS)

**Adresa:** Rruga: Vaçe Zela, Nr 19, Tiranë

**Kontaktet:** [projekte@shisalbania.org](mailto:projekte@shisalbania.org)

## ABSTRAKT

Ekstremizmi i dhunshëm është një dukuri që kërcënon sigurinë e shkollës dhe komunitetit, si një ndër sfidat më të përhapura me të cilën shoqëritë po përballen në ditët e sotshme. Kjo dukuri nuk bën dallime moshe, gjinie, etnie, kombi, grupi apo komuniteti. Një ndër grupet më të prekura janë të rinjtë të cilët janë më lehtësisht të ndikueshëm ndaj mesazheve ekstreme të dhunshme që shpërndahen online dhe fizikisht nga rekrutues që mund të jenë pjesë e organizatave terroriste.

Të dashur mësues,

në këtë udhëzues ju do të keni një panoramë të përgjithshme mbi dukurinë e ekstremizmit të dhunshëm dhe mënyrave sesi ju mund të identifikoni nxënës që shfaqin shenja të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në shkollë. Vëmendje e veçantë nevojitet të tregohet në referimin e rasteve për trajtim përtej shkollës, si tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve ashtu edhe tek Këshilli Vendor i Sigurisë Publike.

Gjithashtu, evidentojmë se roli i mësuesit koordinator “Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” në shkollë është kryesor dhe i pazëvendësueshëm për tematikën në kuadër të planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit me qëllim parandalimin, menaxhimin dhe referimin rasteve.

*Faleminderit!*

## Lista e shkurtimeve

- SHIS	Shoqata Internacionale për Solidaritetin
- MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
- NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
- KEDH	Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
- CVE Center	Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
- EDH	Ekstremizmi i Dhunshëm
- PV	Plani i Veprimit

## Termet kyç:

Në vijim të përmbushjes së nevojave të këtij udhëzuesi është me rëndësi të njohim përkufizimet e termave kyç që do të trajtohen përgjatë këtij dokumenti. Kjo, jo vetëm që secili të njihet me përkufizimin e plotë dhe të saktë të tyre por për të patur të njëjtën terminologji në të shprehur dhe punuar përballë këtyre dukurive.

**Dhunë** - nënkupton: “Të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit, ngacmimit seksual, neglizhencës, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo dinjitetit të individit në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit apo forcës” (sipas OBSH-së).

**Ekstremizmi**<sup>1</sup> - Në kuptimin e plotë të fjalës, “ekstremizmi” nënkupton “besimin dhe mbështetjen për idetë që janë shumë larg nga ajo që shumica e njerëzve i konsiderojnë të sakta ose të arsyeshme”. Pra “ekstremizmi” u referohet qëndrimeve ose sjelljeve që konsiderohen jashtë normës.

**Ekstremizmi i dhunshëm** - u referohet besimeve dhe veprimeve të njerëzve që e mbështesin ose e përdorin dhunën për t'i arritur qëllimet ideologjike, fetare apo politike. Kjo përfshin terrorizmin dhe

---

1. Përkufizime lidhur me ekstremizmin dhe radikalizmin, të përdorura nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën e Kulturën, (UNESCO).

format e tjera të dhunës së motivuar politikisht apo edhe nga sektet e ndryshme. Në mënyrë të veçantë, “ekstremizmi i dhunshëm” identifikon gjithashtu një armik ose armiqtë, të cilët janë objekt i urrejtjes dhe dhunës. Bërthama konceptuale e ekstremizmit të dhunshëm është një mjet i motivuar ideologjikisht për përdorimin e dhunës, zakonisht e bazuar në teoritë e konspiracionit.

**Ekstremizëm i dhunshëm<sup>2</sup>** - Përdorimi i dhunës për arritjen e objektivave politikë.

**Radikalizmi** - ashtu si për termin “ekstremizëm”, termi “radikalizëm” diskutohet shumë kur përdoret në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm. Shqetësim është se përdorimi i këtij termi mund të shërbejë për t’i arsyetuar kufizimet e fjalës së lirë. Në të vërtetë, termi “radikal” në kontekste të caktuara, thjesht, ka kuptimin e asaj “që dëshiron të shkaktojë ndryshime politike”. Në kontekstin e përpjekjeve për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, “radikalizmi” zakonisht përdoret për t’i përshkruar proceset, me të cilat një person ka pikëpamje apo përdor praktika ekstreme, deri në atë pikë sa ta legjitimojë përdorimin e dhunës. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit, e datës 16 maj 2005, nuk e përcakton termin “radikalizëm”, por në nenin 5, përmban përkufizimin për “provokim publik për kryerjen e veprës terroriste” si: “shpërndarja, ose vënia në dispozicion e një mesazhi për publikun, me qëllim për të nxitur kryerjen e një veprë terroriste, ku një sjellje e tillë,

---

2. Idem, faqe faqe13249

në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, përkrah veprat terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla mund të kryhen". Konventa përcakton gjithashtu "rekrutimin për terrorizëm" (Neni 6), si: "akt për t'i kërkuar një personi tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, ose për t'u bashkuar me një grup, me qëllim për të kontribuar në kryerjen e një apo më shumë veprave penale terroriste nga ana e këtij grupi".

**Radikalizimi në dhunë<sup>3</sup>** - Një vendim për të anashkaluar proceset politike apo metodat jo të dhunshme të nxitjes së ndryshimit, duke favorizuar përdorimin e metodave të dhunshme për të sjellë ndryshimin.

**De-radikalizimi** - Aktivitetet e ndërmarra për ta ndryshuar mentalitetin e një individi radikal kundrejt pranimi ose miratimit të një ideologjie të dhunshme ekstreme, me qëllim që ta pengojë atë për të ndërmarrë veprime të dhunshme në të ardhmen.

**Kundëradikalizimi<sup>4</sup>** - Një paketë programesh sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur (dhe, me gjasë, tashmë të radikalizuar) që t'i drejtohen terrorizmit.

**Qëndresë<sup>5</sup>** - Faktorët, idetë, institucionet, çështjet, prijet ose vlerat që i'u japin mundësi individëve

- 
3. Strategjia Kombëtare Për Luftën Kundër Ekstremizmit Të Dhunshëm, Fletorja Zyrtare, viti 2015 numri 203, faqe13249
  4. Idem, faqe faqe13249
  5. Idem, faqe faqe13249



dhe komuniteteve t'i bëjnë qëndresë dhunës ose ta parandalojnë atë. "Luftëtarë të huaj terroristë", individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përfitim e trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosura.

## Kujdes:

Për informacione më të detajuara mbi temën ju lutem klikoni:

- faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë në rubrikën "Parandalimi i ekstremizmit në arsimin parauniversitar"
- faqen zyrtare të Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, "CVE Center".

## Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje .....	10
2.	Kuadri ligjor .....	13
3.	Identifikimi i nxënësve që shfaqin shenja të ekstremizmit të dhunshëm.....	15
	3.1 Arsyet .....	15
	3.2 Faktorët .....	16
	3.3 Shenjat/treguesit .....	16
	3.4 Nivelet.....	17
4.	Trajtimi i fëmijëve të radikalizuar nga grupi i punës në shkollë .....	18
	4.1 Mjedisi fizik.....	19
	4.2 Koordinimi brenda shkollës për menaxhimin e rasteve dhe mekanizmi referues .....	20
	4.3 Drejtori i shkollës.....	21
	4.4 Mësuesi koordinator për ndjekjen e planit të veprimit KEDH.....	22
	4.5 Mësuesi kujdestar i klasës .....	24
	4.6 Psikologu/punonjësi social .....	26
	4.7 Oficeri i sigurisë në shkollë.....	27
	4.8 Prindi.....	28
5.	Referimi i rasteve për trajtim multidisiplinar (NJFM, këshillat vendor të sigurisë publike).....	30

# 1. Hyrje

Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi, në të gjitha format e shfaqjet, përbëjnë, aktualisht, kërcënimet më serioze për paqen dhe sigurinë në mbarë botën. Kësisoj, lufta kundër këtyre kërcënimeve, pavarësisht se ku ndodhin apo nga kush vijnë, kërkon që aktorët qeveritarë të forcojnë bashkëpunimin në nivel kombëtar, si dhe atë rajonal e global.

**Global-** Në konceptimin e një kundërpërgjigjeje shqiptare ndaj ekstremizmit të dhunshëm, Strategjia Globale e Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit do të mbetet platforma e përbashkët për të gjitha përpjekjet e ardhshme. Për më tepër, Shqipëria do të vijojë të mbështetë fort përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit, si dhe të përhapë standardet e Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit, ndërkohë që garanton të drejtat e njeriut dhe forcon shtetin e së drejtës. Shqipëria është e angazhuar që të japë një kontribut thelbësor e të prekshëm në përpjekjet ndërkombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit: - Shqipëria ishte mes vendeve të para që iu përgjigjën sfidës që lidhej me ekstremizmin e dhunshëm dhe aktualisht po luan një rol aktiv si pjesë e koalicionit global në luftën kundër ISIL /Da'esh-it. - Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar konventat dhe protokollat e Kombeve të Bashkuara mbi terrorizmin dhe përpos kësaj është bashkësponsorizuese e Rezolutës 2178 (2014) të Këshillit të Sigurimit të

Kombeve të Bashkuara, si edhe Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit.

**Rajonal-** Në maj të vitit 2015, Shqipëria mbajti Samitin Rajonal Ballkanik kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në Tiranë, ku përfaqësues të vendeve të rajonit theksuan nevojën për përmirësimin e bashkëpunimit, jo vetëm për t'iu kundërpërgjigjur ekstremizmit, por edhe për t'iu përballur me vështirësitë lidhur me të që has rajoni. Bashkë me samitin e majit të vitit 2015, në Tiranë, Samiti i Shtëpisë së Bardhë kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (shkurt 2015) dhe Samiti i Udhëheqësve në Nju-Jork (shtator 2015) *Fletorja Zyrtare Viti 2015 – Numri 203 Faqe | 13248* janë gurë të rëndësishëm kilometrikë në zbatimin e Strategjisë Globale të Kombeve të Bashkuara kundër Terrorizmit

**Kombëtar-** Përgjatë viteve të fundit, Shqipëria, si edhe shumë vende e tjera, është përballur me një rritje të radikalizmit dhe shfaqje të ekstremizmit të dhunshëm të demonstruara në komunitet dhe në ambientet e shkollave. Mes viteve 2012 dhe 2014, 144 Shqiptarë të ndarë në kategoritë : burra, gra dhe fëmijë kanë udhëtuar jashtë vendit, për t'iu bashkuar me grupet terroriste. Megjithëse, fluksi i shqiptarëve që udhëtojnë për të luftuar në Siri dhe Irak duket se ka ndalur në vitin 2015, radikalizmi dhe dhuna ekstreme vazhdojnë të përbëjnë një rrezik për shoqërinë e gjerë, përfshirë kërcënimet e brendshme terroriste apo ndikimet e jashtme nëpërmjet përdorimit të internetit dhe individëve që financojnë terrorizmin dhe ndihmojnë në rekrutime.

Bazuar tek Strategjia, Shoqata SHIS në bashkëpunim me Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe

Rinisë (MASR), falë mbështetjes financiare të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë organizoi sesione trajnimi për rrjetin e mësuesve koordinatorë për ndjekjen e planit të veprimit KEDH. Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për rolin kyç që ka mësuesi koordinator në planifikim, monitorim dhe vlerësim për të parandaluar, menaxhuar dhe referuar rastet brenda dhe jashtë shkollës. Për këtë, mësuesit e rrjetit u trajnuan mbi identifikimin e shenjave të hershme të radikalizmit dhe ekstremizmit në sjelljet e nxënësve, mbi mënyrat se si të nxisnin motivimin dhe kreativitetin e tyre në shkollë me qëllim për të kanalizuar energjitë e tyre në aktivitete edukative dhe zhvilluese për ta. Në këtë kuadër hartohet ky udhëzues për t'i ardhur në ndihmë rrjetit të mësuesve KEDH që:

- Të identifikojnë në kohë shenjat tipike tek nxënësit;
- Të vlerësojnë rastet midis grupit multidisiplinar të shkollës;
- Të planifikojnë plane veprime konkrete për të parandaluar dhe funksionuar si një rrjet i mirë koordinuar në menaxhim dhe referim rasti.

## 2. Kuadri ligjor



Siguria e fëmijës/nxënësit në shkollë në kuadër të parandalimit të EDH është konsideruar si prioritet nga Qendra CVE dhe MASR-ja dhe si pasojë e koordinimit të masave për parandalim të EDH është hartuar Plani i Veprimit (PV) i bazuar në aktivitetet e mëposhtme:

- a) Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve në mjediset shkollore me qëllim identifikimin e pranisë së ekstremizmit të dhunshëm;
- b) Zhvillimi i sesioneve informuese trajnuese për administratën shkollore mbi njohjen dhe menaxhimin e shenjave të ekstremizmit dhe radikalizmit;
- c) Harmonizimi i aktiviteteve të CVE-së me programet ekzistuese për angazhimin e nxënësve në zonat me rrezik të lartë për radikalizëm;
- d) Hartimi i programeve/moduleve/kurrikulave të ndryshme për parandalim dhe ri-integrim të nxënësve të radikalizuar në shkollë;
- e) Aftësimi i aktorëve të arsimit parauniversitarë për të ndihmuar përmes arsimit në procesin e deradikalizimit dhe të ri-integrimit;
- f) Raportimi dhe koordinim me strukturat e tjera të komunitetit për trajtimin e rasteve;
- g) Bashkëpunim rajonal dhe më gjerë.

Duke qenë se kurrikula i dedikohet mësuesve të arsimit parauniversitar, nënvizojmë si thelbësore **Konventën për të Drejtat e Fëmijëve**, si dokumenti më i rëndësishëm kombëtar që garanton gjithëpërfshirjen dhe mbron në

mënyrë parësore të drejtat e secilit fëmijë në të gjithë botën. Kjo konventë bazohet tek parimet bazë të **garantimit të interesit më të lartë të fëmijës duke zhvilluar potencialin e tij nëpërmjet pjesëmarrjes me qasje gjithëpërfshirëse.**

Kështu, në kontekst të parandalimit të EDH parashikohen nevojat e veçanta të atyre fëmijëve që janë veçanërisht të pambrojtur ndaj rekrutimit ose përdorimit në veprime luftarake në kundërshtim me këtë protokoll për shkak të gjendjes së tyre ekonomike, shoqërore apo gjinore, duke ditur domosdoshmërinë e të bindura për nevojën e forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e këtij protokollit, si dhe rehabilitimin fizik dhe psikologjik dhe ri-integrimin shoqëror të fëmijëve që janë viktimat të konflikteve të armatosura.<sup>6</sup>

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** trajton çështje të dhunës ndaj fëmijëve në mënyrë specifike dhe të drejtpërdrejtë, duke u siguruar fëmijëve të drejtën themelore për t'u mbrojtur (Neni 54). Sipas Kushtetutës, fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti; të drejtën për t'u mbrojtur nga dhuna dhe keqtrajtimi; të drejtën për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi dhe puna që mund të jetë e dëmshme ose që mund të vërë në rrezik shëndetin ose zhvillimin e tyre.

Më tutje, brenda legjislacionit të arsimit parauniversitar (ligje, aktet nënligjore apo udhëzime) ndalohet dhuna në institucionet edukative publike dhe private.

Siguria në shkolla sigurohet jo vetëm me njohjen e mirë të legjislacionit në fuqi, por edhe me zbatimin rigoroz të tij.

---

6. Ligji Nr.9833, date 22.11.2007 Për Aderimin e Republikës Së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB, "PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE", për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 165, Datë. 10/12/2007

## 3. Identifikimi i nxënësve që shfaqin shenja të ekstremizmit të dhunshëm



### 3.1 Arsyet

1. Nxënësi po përpiqet të kuptojë ndodhi të ndryshme për jetën;
2. Ndihet sikur kultura e tij/saj, feja, identiteti është kërcënuar;
3. Ka mungesë ndjenje përkatësie;
4. Është i/e dhënë pas aventurave dhe gjërave sensacionale;
5. Një mik apo familjar i tij/saj ka qenë viktimë e një krimi/apo në Siri;
6. Ka përvojë personale me diskriminim dhe kërkon që t'i ndryshojë gjërat;
7. I bëhet presion nga bashkëmoshatarët/ apo më të rriturit e përfshirë në këtë çështje;
8. Është i/e lidhur me plagë historike;
9. Ka vështirësi në të nxënë;
10. Ka pasiguri apo marrëdhënie konfliktuale;
11. Ka pasur apo vazhdon të ketë përvoja traumatike në jetë;
12. Është i/e distancuar nga trashëgimia kulturore/fetare;



13. Nuk i janë përmbushur aspiratat;
14. Ka ndërveprim social të kufizuar;
15. Ka “plagë” të vjetra të pashëruara.

### 3.2 Faktorët


1. Mungesë vetëbesimi, turp, ankth;
2. Mungesë mbështetje nga familja/  
bashkëmoshatarët;
3. Kontakte të pakta të prindit me shkollën;
4. Ndihen të vetmuar, të braktisur, pa mbrojtje;
5. Vetëfajësohen si frikacakë, dështakë, të pa zotë;
6. Janë të bullizuar apo bullizojnë të tjerët;
7. Janë të marginalizuar;
8. Janë në kërkim të identitetit dhe shpërblimit;
9. Kanë interesa të caktuara;
10. Ju është ofruar një ndjenjë përkatësisë.



### 3.3 Shenjat/treguesit



### 3.4 Nivelet



## 4. Trajtimi i fëmijëve të radikalizuar nga grupi i punës në shkollë



Krijimi i një mjedisi fizik sa më pozitiv larg qasjeve ekstreme të dhunshme në shkollë është një nga çështjet më të rëndësishme dhe prioritare për Shqipërinë, rajonin dhe botën. Qasja pozitive krijohet në mjedisin e shkollës nga të gjithë aktorët që janë pjesë e saj, drejtuesit, mësuesit, psikologët, punonjësit socialë, oficeri i sigurisë, nxënësit, prindërit dhe komuniteti në tërësi. Kjo qasje bazohet tek rëndësia që vetë nxënësit të kenë rolin kryesor në krijimin e klimës demokratike duke pasur fokusin tek respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut. Nxënësit që zotërojnë më shumë njohuri për të drejtat e njeriut, interesohen më shumë për temat ndërkombëtare, mbështesin më shumë edukimin qytetar, gjithëpërfshirjen, si dhe janë ndikuesit më të mëdhenj për nxënësit e tjerë. Duke bërë të fortë dhe

të qëndrueshëm këtë mjedis, ekstremizmi i dhunshëm e ka të vështirë të lindë dhe të mbijetojë.

Të drejtat e njeriut vërtet janë pjesë e kurrikulës shkollore, por ato duhet të jenë pjesë e temave që trajton mësuesi kujdestar në orët edukative, si pjesë e programeve të ndryshme kulturore në shkollë, në klubet jashtëshkollore, si dhe në veprimtaritë e ndryshme që organizohen në mjediset e shkollës.

## 4.1 Mjedisi fizik

Ka për qëllim:

- Të zhvillojë aftësitë debatuuese dhe të dialogimit në frymën e mendimit kritik;
- Të zhvillojë aftësitë e diskutimit dhe të pranimit të idesë se çdo çështje e gjen zgjidhjen vetëm me paqe dhe tolerancë;



- Të mësojë se identiteti i njeriut është kompleks dhe kjo do të thotë se çdo person mund dhe duhet të kuptohet dhe të përshkruhet ndryshe;
- Të zhvillojë vlera, qëndrime dhe sjellje që reflektojnë respektin ndaj tjetrit dhe respektin për njerëzimin si i lindur për të jetuar në një botë me paqe dhe harmoni;
- Të zhvillojë vlera, qëndrime dhe sjellje që të kuptojnë dhe të analizojnë pse njerëzit marrin përgjegjësi personale për të sjellë ndryshime pozitive shoqërore;
- Të rrisë vetëdijen e tyre për përgjegjësitë që lidhen me të drejtat e njeriut, përgjegjësitë e shtetit dhe të institucioneve, por edhe përgjegjësitë e tyre morale;
- Të ndërtojnë një mjedis të qetë, tërheqës, pa diskriminim racor, etnik, fetar etj., ku nuk ka vend ekstremizmi, radikalizmi apo forma të tjera të dhunës.

## **4.2 Koordinimi brenda shkollës për menaxhimin e rasteve dhe mekanizmi referues**

Në çdo shkollë ngrihet një grup koordinues pune duke u kryesuar nga mësuesi koordinator kundër ekstremizmit të dhunshëm, i cili çdo fillim viti akademik merret me hartimin dhe ndjekjen e realizimit të planit kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Grupi drejtohet nga mësuesi koordinator dhe ka në përbërjen e tij mësues të tjerë, psikologun/punonjësin

social, prindër, oficerin e sigurisë në shkollë, nëse ka ose dhe përfaqësues nga komuniteti duke përfshirë NJMF, oficerin e policimit në komunitet, pushtetin vendor etj.

Ky grup në rast nevojë identifikon, menaxhon dhe trajton raste të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm duke hartuar një plan të veçantë nga ku përcaktohen rolet e secilit aktor brenda shkollës, si dhe ndahen përgjegjësitë për dhënien e kontributit në zgjidhjen e tij, duke organizuar veprimtari të ndryshme për trajtimin e rastit, si dhe në fund për përgatitjen e raportit periodik për ecurinë e nxënësit.

Grupi këshillohet me organizmat e tjerë të shkollës për identifikimin, parandalimin dhe trajtimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm.

Ky grup, nëpërmjet angazhimit të koordinatorit, mund të vendosë lidhje edhe me grupe të tjera të koordinimit të shkollave të tjera, me qëllim shkëmbimin e përvojave pozitive në zbatimin e planit kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe në trajtimin e rasteve të fëmijëve të radikalizuar apo atyre të kthyer nga zonat e konfliktit.

Grupi është përgjegjës për realizimin e planit të shkollës kundër ekstremizmit të dhunshëm si dhe planeve të veçanta për trajtimin e rasteve.

Nëse rasti nuk zgjidhet brenda shkollës, atëherë ai referohet në Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve për trajtim ndërinstitucional. Edhe në këtë rast, mësuesi koordinator dhe koordinatori kundër ekstremizmit i zyrës vendore arsimore të arsimit parauniversitar të ZVA-së përkatëse, janë pjesë e grupit ndërinstitucional.

### 4.3 Drejtori i shkollës

Drejtori i shkollës drejton dhe menaxhon të gjitha veprimtaritë në shkollë, përfshirë ato mësimore apo edukative. Ai drejton dhe koordinon organizmat e ndryshëm në shkollë dhe krijon lidhjet midis tyre dhe institucioneve eprorë në fushën e arsimit. Ai mbështet nisma të bashkëpunimit me institucione të tjera shtetërore, agjencitë e specializuara për të drejtat e fëmijëve, me organizata të ndryshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit arsimor dhe krijimit të një mjedisi të sigurt në shkollë.

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes edukimit duhet të jetë në fokus të punës së tij, duke mbështetur mësuesin koordinator, por edhe duke ndërgjegjësuar aktorët e tjerë për rolin e tyre.

Ai duhet të përfshijë në punën parandaluese jo vetëm shkollën dhe mësuesit, por edhe prindërit dhe komunitetin.

Drejtori duhet të nxisë mësuesit, që në planet e tyre të përfshijnë ndërgjegjësimin mbi kërcënimet ndaj ekstremizmit të dhunshëm në shkolla dhe të mbështesë rritjen e kapaciteteve për mësuesit në identifikimin dhe mbështetjen e nxënësve të prekshëm ndaj radikalizmit, si dhe të ndikojë në vendosjen e besimit të ndërsjellë ndërmjet komunitetit dhe shkollës.

Drejtori duhet të motivojë bashkëpunimin jo thjesht për të raportuar, por për të identifikuar me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e rasteve që shfaqin shenja të ekstremizmit, radikalizmit apo të çdo lloj dhune apo abuzimi.

## 4.4 Mësuesi koordinator për ndjekjen e planit të veprimit KEDH

Mësuesi koordinator:

- Zbaton detyrimet e parashikuara në “Planin e Veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe të gjitha angazhimet/orientimet e përcjella nga struktura relevante.
- Harton dhe realizon në bashkëpunim me mësuesit e tjerë planin e veprimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm për shkollën.
- Kontribuon në identifikimin, menaxhimin dhe trajtimin e nxënësve që shfaqin shenja të Ekstremizmit të Dhunshëm në ambientet e shkollës.
- Drejton grupin e punës për menaxhimin dhe rehabilitimin e nxënësve që shfaqin shenja apo sjellje ekstreme të dhunshme duke hartuar planin individual për trajtim të nxënësit në shkollë. Në këtë grup pune përfshihet drejtori i shkollës, psikologu, punonjësi social, mësuesi kujdestar i klasës, oficeri i sigurisë në shkollë dhe prindërit.
- Monitoron në mënyrë periodike realizimin e planit individual mbi ecurinë e nxënësit.
- Raporton për ecurinë e rastit sipas nevojës tek grupi i punës, drejtori i shkollës dhe zyra vendore arsimore apo në platformën online.



## VËMËNDJE!

Çdo shkollë harton për vitin akademik një plan aktivitetesh “Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm”. Hartimi i këtij plani bëhet duke pasur parasysh problematikat që shkolla ka pasur ndër vite si dhe duke analizuar elementët që mund të shtyjnë nxënësit drejt shfaqjes së ekstremizmit të dhunshëm. Mësuesi koordinator bashkëpunon me administratën shkollore, nxënësit, prindërit dhe komunitetin për realizimin e aktiviteteve të parashikuara për vitin akademik.

Shkollat kanë planet e tyre të veprimit në fusha të ndryshme dhe një ndër ta është edhe plani i veprimit kundër ekstremizmit të dhunshëm. Çdo shkollë e ndërton këtë plan, bazuar në planin e veprimit të MASR-së, por duke i’u referuar specifikave të saj si shkollë.

Hartimi i planit bëhet duke pasur parasysh analizën e shkollës, pikat e saj të forta dhe të dobëta dhe mundësitë e shfaqjes së ekstremizmit dhe radikalizmit në shkollë dhe në komunitetin ku ajo zhvillon veprimtarinë.

Të gjithë aktorët që punojnë në shkollë dhe bashkëpunëtorët e tjerë njihen me këtë plan për të dhënë kontributin e tyre në hartimin dhe realizimin e tij.

Drejtori i shkollës cakton një mësues koordinator për ndjekjen e këtij plani, i cili raporton në drejtori dhe tek koordinatori përgjegjës në zyrën vendore të arsimit parauniversitar.

Mësuesi koordinator bashkëpunon për identifikimin dhe zgjidhjen e rasteve të sjelljeve ekstreme të dhunshme për fëmijët e radikalizuar, me të gjithë aktorët e shkollës të cilët kanë detyrim të raportojnë në drejtorinë e shkollës.

Mësuesi koordinator planifikon takime dhe veprimtari konkrete duke kërkuar mbështetje për trajtimin e rasteve, sipas veçorive të tyre. Ai raporton ecurinë e rastit dhe jep sugjerime për të kërkuar ndihmë nga mekanizma të tjerë vendorë.

## 4.5 Mësuesi kujdestar i klasës

Mësuesi kujdestar është një nga mësuesit lëndorë të shkollës, por që kujdeset në mënyrë të veçantë për një klasë të caktuar. Ai ka detyrimin të njohë për çdo nxënës të klasës gjendjen e tij sociale dhe ekonomike si dhe të ndjekë ecurinë dhe përparimin e tij të gjithanshëm gjatë vitit mësimor. Mbi këtë njohje ai ndërton planin e orëve të kujdestarisë ku vendos tema dhe aktivitete të caktuara që zhvillon me klasën e tij.

Ky mësues bashkëpunon ngushtë me drejtuesit e shkollës, psikologun ose punonjësin social, kolegët e tjerë mësues, oficerin e sigurisë në shkollë, si dhe me prindërit e nxënësve.

Në ndërtimin e planit të punës ai udhëhiqet nga identifikimi i problematikave të klasës si dhe nga planet e tjera zhvillimore të shkollës. Një prej këtyre planeve është edhe plani i luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Në orët e kujdestarisë ky mësues zhvillon tema që të kenë në themel: respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat zhvillojnë vlera dhe qëndrime të respektit, të diversitetit, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe të vullnetit për të pranuar dhe

arritur kompromise që nxisin bashkëpunimin konstruktiv të nxënësve me njëri-tjetrin; që të vlerësojnë stereotipat e ndryshëm dhe të luftojnë paragjykimet; që t'i mësojnë se si të përballen me kompleksitetin e jetës, duke diskutuar dhe duke qenë të hapur; që të zgjerojnë njohuritë e tyre për të drejtat e njeriut dhe të kuptojnë si funksionojnë të drejtat e njeriut të pranuar ndërkombëtarisht; se çfarë është ekstremizmi, radikalizmi dhe rreziqet që vijnë prej tij, etj.

Në këtë frymë, ai organizon aktivitete me klasën, ku çdo nxënës, e sidomos ata me shfaqje të sjelljeve ekstremiste apo në rrezik, të ndihet i vlerësuar dhe lider në një fushë të caktuar, të ketë mundësi të shfaqë vlerat e tij/saj pozitive dhe të ndihet i përfshirë dhe i dobishëm.

Mësuesi kujdestar kërkon mbështetje tek aktorët e tjerë në shkollë për zgjidhjen e problematikave të shfaqura duke bashkëpunuar ngushtësisht edhe me prindërit.

Në mënyrë që shfaqjet ekstremiste të parandalohen, mësuesi kujdestar edukon në klasë një kulturë gjithëpërfshirëse ku të mbizotërojë besimi, respekti, siguria dhe transparenca. Mësuesi është shembull i sjelljes, i komunikimit, i respektimit të dinjitetit të nxënësve, sidomos në situata kur ka sjellje të ndryshuara të tyre, deri edhe sjellje agresive. Mësuesi duhet të dijë të dëgjojë, të njohë të drejtën e shpërthimit të emocioneve të nxënësit duke punuar për analizimin e shkaqeve me qëllim përmirësimin e situatës. Ai kultivon tek nxënësi besimin se vetëm duke qenë pranë njëri-tjetrit, në një mjedis të qetë dhe bashkëpunues arrihen zgjidhjet afatgjata. Nxënësi duhet të gjejë veten në shkollë duke garantuar mbi të gjitha sigurinë fizike dhe emocionale, lirinë e mendimit dhe mundësinë e të nxënësit të qytetarisë globale, duke përjashtuar nga vetja e tij sjelljet ekstreme të dhunshme.

## 4.6 Psikologu/punonjësi social

Psikologu/ punonjësi social planifikon dhe ofron mbështetjen e tij për zhvillimin e nxënësit në aspektin arsimor, social, por edhe personal. Ky lloj shërbimi ofrohet natyrshëm kur ai bashkëpunon me të gjithë mësuesit, drejtuesin e shkollës, nxënësit dhe prindërit.

Ai identifikon dhe vlerëson nxënësit me probleme në sjellje, nxënësit me vështirësi në të nxënë si dhe harton plane individuale për trajtim psikologjik. Në këtë mënyrë ai vepron edhe me nxënësit që shfaqin sjellje ekstreme të dhunshme, apo për fëmijët e kthyer nga zonat e konfliktit. Planet dhe shërbimet e tij ofrohen për çdo nxënës, por në mënyrë të veçantë ai punon me raste specifike të nxënësve, siç mund të jenë edhe nxënësit që preken në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ekstremizmi, bullizmi, dhuna apo çdo lloj tjetër abuzimi.

Psikologu/punonjësi social duhet të jetë pjesë e temave në orët e kujdestarisë së çdo klase, si dhe pjesë e hartimit të planit të shkollës për mbështetje psiko- sociale të nxënësve duke organizuar veprimtari në funksion të krijimit të një mjedisi pozitiv, miqësor dhe të konsoliduar në shkollë.

Ai duhet të këtë aftësi profesionale për të trajtuar raste të ndryshme të nxënësve me probleme në sjellje, përkatësisht atyre me shfaqje ekstreme të dhunshme duke bërë vlerësimin e tyre gjatë ecurisë së trajtimit si dhe duke mundësuar rekomandime për përmirësimin e punës ose për referimin e rastit tek mekanizma të tjerë institucionalë, në agjencitë për mbrojtjen e fëmijëve në njësitë vetëqeverisëse të pushtetit vendor.

Psikologu krijon besim tek të gjithë nxënësit e sidomos tek ata me probleme në sjellje, duke e bërë kështu figurën e

tyre miqësore, si një person mirëkuptues, pranues, pa asnjë paragjykim dhe mbi të gjitha të besuar.

## 4.7 Oficeri i sigurisë në shkollë

Oficeri i sigurisë kujdeset për një mjedis të qetë brenda dhe përreth shkollës, duke bashkëpunuar ngushtë me stafin në shkollë, por edhe me strukturat e policimit në komunitet.

Është në detyrat e tij që jo vetëm të mbrojë nxënësit nga forma të ndryshme të dhunës, por edhe të mbështesë nxënësit për të kuptuar se duhet të distancohen nga çdo lloj dhune apo abuzimi, nga drogat, alkooli, duhani, ekstremizmi i dhunshëm, etj.

Oficeri i sigurisë bashkëpunon me stafin e shkollës për të njohur nxënësit, për të shkëmbyer informacion për ndryshimet në sjellje dhe për të dhënë ide për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve. Gjithashtu, ai bëhet pjesë e grupit të punës për hartimin e planit individual për trajtimin e nxënësve që shfaqin shenja ekstreme të dhunshme. Ai referon rastet për trajtim në grupin e punës të ngritur në shkollë duke respektuar protokollin përkatës të referimit, si dhe referon tek oficeri i policimit në komunitet rastet problematike.

Duke qenë se oficeri i sigurisë, ashtu si edhe psikologu apo punonjësi social nuk ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me mësimdhënien, ka më shumë shanse që nxënësit të jenë më të hapur me ta dhe këshillohet që ai t'i vëzhgojë sjelljet e tyre edhe jashtë klasës. Kjo përbën një mundësi më shumë që ai të identifikojë sjellje të ndryshme që nuk manifestohen në klasë, apo të shohë se me kë shoqërohen nxënësit që shfaqin ndryshime në sjellje.

Ai mund të bëjë punë individuale me këta nxënës duke vënë në dijeni drejtorinë e shkollës, mësuesin kujdestar dhe mësuesin koordinator kundër ekstremizmit të dhunshëm në shkollë.

## 4.8 Prindi

Prindërit janë pjesë aktive e organizmave të shkollës, duke filluar që nga këshilli i prindërve të klasës, këshilli i prindërve të shkollës, duke u bërë kështu pjesë e hartimit të planeve të saj. Prindi dhe shkolla në bashkëpunimin e tyre ndërtojnë një udhë të përbashkët, ku fëmija të ecë i qetë dhe të kuptojë që këto ura bashkëpunimi forcojnë mirëqenien e tij të sotme dhe e përgatisin atë për të ardhmen, dhe vetëm këtu ai mund të gjejë vetveten larg ndikimeve dhe ideve ekstreme të dhunshme.

Çdo prind angazhohet në bashkëpunimin me shkollën për shkëmbimin e informacioneve mbi ecurinë e fëmijës. Prindi duhet t'i kushtojë kujdes edukimit të fëmijës gjatë gjithë kohës nëpërmjet vëzhgimit të fëmijës në shtëpi mbi ndryshimet në sjellje, veshje, shoqëri, apo në komunikimin në rrjetet sociale. Është shumë e rëndësishme që prindërit të krijojnë në familje një mjedis të qetë dhe të ngrohtë duke mundësuar kështu bindjen tek fëmijët se familja është një vend i sigurt ku ata mund të shprehen lirshëm, të debatojnë, të dëgohen dhe të vlerësohen.

Prindi nxit fëmijën për të qenë aktiv, kreativ, komunikues, tolerant, por ka raste të tjera kur prindi në mënyrë të pandërgjegjshme apo të ndikuar nga ide të ndryshme ekstremiste dhe radikale, mund të çojnë fëmijën e tij në rrugë të gabuar.



## 5. Referimi i rasteve për trajtim multidisiplinar (NJMF, këshillat vendor të sigurisë publike)

Para se nxënësi të referohet tek struktura të tjera, shkolla ka detyrimin për trajtimin e nxënësit bazuar në një program individual me qasje kurrikulare dhe ekstrakurrikulare gjithëpërfshirëse.

Institucionet arsimore kanë përgjegjësinë për menaxhimin dhe referimin e rasteve si dhe koordinimin ndërmjet tyre me qëllim garantimin e sigurisë, mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Referimi i rasteve problematike që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe që janë relativisht të pamënaxhueshëm nga institucioni arsimor, të fëmijëve në nevojë për mbrojtje bëhet duke u bazuar në parimin e interesit më të lartë të fëmijës/nxënësit, të respektimit të dinjitetit e personalitetit të fëmijës/nxënësit, konfidencialitetin, promovimin e të drejtës së fëmijës/nxënësit për mbrojtje dhe përkujdesje, respektimin e të drejtës për t'u dëgjuar, informuar, në lirinë e shprehjes, mosdiskriminimin, partneritetin e bashkëpunimin, si dhe në respektimin e përgjegjësive.

Punonjësit e institucioneve arsimore, çdo mësues dhe çdo ofrues i shërbimit psiko-social në shkolla, oficerët e sigurisë, bëjnë identifikimin e fëmijëve që shfaqin shenja





të ekstremizmit të dhunshëm si dhe janë në nevojë për mbrojtje dhe referimin në kohë tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, në nivel Bashkie apo tek Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, në nivel njësie administrative dhe në varësi të rrethanave të rastit, pranë organeve të policisë.

Drejtuesi i institucionit arsimor cakton personin përgjegjës (rekomandohet mësuesi koordinator kundër ekstremizmit të dhunshëm) që do të asistojë punonjësit e institucionit, për raportimin e rasteve të identifikuara dhe koordinimin e veprimeve për mbrojtjen e fëmijëve, në kuadër të menaxhimit të rastit duke njoftuar Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Personi përfaqësues i institucionit arsimor është përgjegjës për lehtësimin dhe mbështetjen e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes, hartuar nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve i cili parashikon ndjekjen e shkollës nga fëmijët në nevojë për mbrojtje si dhe merr pjesë në takimet e Grupit Teknik Ndërsektorial ku do të trajtohet rasti.

Rastet që nuk gjejnë dot zgjidhje, referohen në Këshillin Vendor të Sigurisë publike, i cili kryesohet nga kryetari i Bashkisë dhe ku bëjnë pjesë aktorë vendorë që përfaqësojnë policinë e shtetit dhe atë bashkiake, shërbimet sociale, arsimin, shërbimet shëndetësore, shërbimin pyjor dhe mjedisin, prefekturën, shoqërinë civile, bashkësitë fetare, komunitetin e biznesit, mediat lokale, grupet vullnetare, dhe organizata të tjera vendore. Sipas rregullores së Këshillit, ngrihen grupet e punës “ad hoc”, të cilat do të trajtojnë rastin në ambientet e institucionit arsimor. Këshilli lehtëson komunikimin, koordinimin dhe bashkëpunimin midis të gjithë aktorëve të komunitetit për zbatimin e planit individual të rastit brenda shkollës dhe në komunitet.



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania

Me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve  
me Publikun të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë